



Pranuar / Dorezuar Punëdhënësi / Prodhuesi Received / Delivered	30.03.2022	viti god year
Organ / Institucia Organ / Institution Org / Inst	Nr. Prot Bil. Prot Prot No	Shtesa Prelim Appendix
SPINSHK	1717/2022	111



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 19 /2022
Datë: 30.03.2022

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, si dhe nenin 2 paragrafi 5 të Rregullores Nr.02/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.04/2018, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*Këshilli*) në mbledhjen e pestë (V) të mbajtur më datë 30.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Raporti i Kolegjit të Këshillit lidhur me vlerësimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për vitin 2020 në Agjencinë Pyjore të Kosovës.
2. Kryeshefi Ekzekutiv në Agjencinë Pyjore të Kosovës obligohet për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandime është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Jeton KOCA
Kryetar i Këshillit

Vendimi i dërgohet:

- Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë Pyjore të Kosovës
- Menaxherit të Personelit në Agjencinë Pyjore të Kosovës
- Arkivit të Këshillit.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERV. OF KOSOVO



Primer / Dorezuar Punimje / Predato Received / Delivered		30.03.2022		2 viti god year	
Organ / Shërbim Organ / Service Org / Unit	In Pro In Pro In Pro	Shërbim / Shërbim Service	Sasia Sasia Quantity		
SKPMShCK	1717/2022		1/20		

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MONITORIMIT

PËR VITIN 2020

në

AGJENCINË PYJORE TË KOSOVËS

Prishtinë, 2022

PËRMBAJTJE

PËRMBAJTJE	2
HYRJE	3
FUNKSIONI I MONITORIMIT	4
OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT	5
FUSHA E MONITORIMIT	6
RAPORTI I MONITORIMIT NË AGJENCINË PYJORE TË KOSOVËS	7

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tutje referuar si Këshilli*) është institucion i pavarur në kuadër të Kuvendit që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore:

- *shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidateve për pranim në shërbimin civil;*
- *monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.*

Këshilli, funksionet dhe përgjegjësitë themelore i ushtron në pajtim me:

- *Kushtetutën e Republikës së Kosovës;*
- *Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- *Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrat e Publikë;*
- *Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;*
- *Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;*
- *Rregulloren Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- *Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- *Rregulloren Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil;*
- *Rregulloren Nr.05/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.*

FUNKSIONI I MONITORIMIT

Këshilli, krahas funksionit të shqyrtimit dhe vendosjes se ankesave të nëpunësve civil dhe kandidateve për pranim në shërbimin civil, ushtron edhe funksionin e monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Ketë funksion Këshilli e ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe dispozitat e Rregullores Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit në Institucionet e Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

Këshilli, përmes ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike, mbikëqyrë zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil me qëllim të krijimit të një administratë publike profesionale dhe efikase, sipas standardeve me të mira evropiane.

Funksionin e monitorimit, Këshilli e ushtron përmes monitorimit të rregullt që realizohet sipas planit vjetor të monitorimit, dhe përmes monitorimit të jashtëzakonshëm që realizohet në raste të veçanta që ndërlidhen me shkelje të rënda të legjislacionit për shërbimin civil.

Këshilli, në procesin e monitorimit të institucioneve të administratës publike përgatit raport me të gjetura dhe rekomandime dhe nxjerr vendim, të cilin së bashku me raport ia dërgon institucionit përkatës. Institucioni përkatës i administratës publike është i obliguar për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit, brenda afatit të përcaktuar me vendimin e Këshillit.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Monitorimi i institucioneve të administratës publike ka për qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësive për realizimin e objektivës sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në për zgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

FUSHAT E MONITORIMIT

Këshilli, me qëllim të ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e monitorimit.

Sipas Rregullores Nr.04/2018 për procedurën e monitorimit në institucionet e administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, fushat të cilat monitorohen nga Këshilli janë:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat lidhur me përfaqësimin etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale apo është i dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Ngacmimet Seksuale;

Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Monitorimin e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil

RAPORT I MONITORIMIT LIDHUR ME ZBATIMIN E RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË AGJENCINË PYJORE TË KOSOVËS PËR VITIN 2020

Këshilli, gjatë procesit të monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Agjencinë Pyjore të Kosovës për të vlerësuar drejtë dhe në mënyrë të paanshme ligjshmërinë e veprimeve të ndërmarra nga zyrtaret përgjegjës të institucionit përkatës, përveç mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës monitoruese më datë 06 dhe 07 prill 2021, në prezencë të Udhëheqësit të Njesisë për Burime Njerëzore, si mostra për shqyrtim ka marr një mori të dokumenteve relevante (kopje), si në vijim: Rregullorja QKR–Nr.16/2014, për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës; kërkesa urgjente për monitorim të jashtëzakonshëm e datës 29.05.2020, 22.10.2020, 01.12.2020, 11.03.2021, Plan i vjetor i trajnimit për vitin 2020 i datës 31.01.2020; Vendim i Agjencisë Pyjore të Kosovës për qasje në dokumente publike i datës 18.03.2021; Institucioni Agjencia Pyjore e Kosovës totali i shërbyesve civil; Vendim i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me numër protokolli 1442 i datës 10.04.2020; Vendim i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ref.120/20 i datës 28.04.2020; Vendim ref.Ke-310/2020 i datë 27.04.2020 për Emërim të Kryetarit dhe Anëtarit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendim Ref.SBNJD-32/2020 i datës 06.02.2020 i Komisionit Disiplinor, Vendim Ref.SBNJD-83/2020 i datës 13.03.2020 i Komisionit Disiplinor; Vendim Ref.KE-309/2020 i datës 27.04.2020 për Emërimin e Komisionit Disiplinor në Agjencinë Pyjore të Kosovës; Vendim Ref.KE-740/2020 i datës 17.09.2020 për Emërimin e Komisionit Disiplinor në Agjencinë Pyjore të Kosovës Formulari i planit individual të personelit i datës 24.12.2019; Vendim i KPMSCHK me Nr. A/02/403/2016 i datës 07.11.2016; Vendim për transferim i datës 21.11.2016; Vendim i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 09.08.2016; Vendim për emërimin e ushtruesit të detyrës i datës 31.01.2020; Urdhër pagesë për paga dhe shtesa e muajit dhjetor 2020; Diplomë me numër 1741 e datës 14.12.2014; Vendim i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 10.02.2015; Vendim i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 06.05.2015; Vendim për pagesën e shtesës për rrezikshmërinë në punë i datës 07.04.2015 ; Dosja personale për Zyrtar për Silvikulturë; Dosja personale për Zyrtar për Planifikim dhe Shfrytëzimin e Pyjeve, Inspektor për Sivikulturë, Dosja

personale për Inxhinier i Pylltarisë dhe Drejtor i Drejtoriatit për Hulumtim, Dosja personale për Zyrtar Projektim dhe Prodhim Fidanor; Vendim Ref.KE-72/20 i datës 31.03.2020 për emërimin e Ushtruesit të Detyrës të Inspektorit në DQIPGJ-APK. Emaili i Menaxheres së Personelit i datës 22.09.2020 lidhur me deklarin e statusit të zyrtareve të Agjencisë Pyjore, Formulari për vlerësimin e punës provuese i i datës 29.01.2021; Formulari për vlerësimin e punës provuese i datës 05.02.2021; Formulari për vlerësimin e punës provuese i datës 26.01.2021; Evidenca e Pushimeve Vjetore, Mjekësore të lindjes atyre pa pagesë etj; Vendim për ndërprerjen e shfrytëzimit të pushimit prindëror lehonisë i datës 07.04.2020; Vendim për shfrytëzim të pushimit prindëror lehonisë i datës 01.07.2019; Kërkesa për pushim prindëror e datës 01.07.2019; Vendim për ndërprerjen e shfrytëzimit të pushimit prindëror lehonisë i datës 29.10.2020; Vendim për shfrytëzim të pushimit prindëror lehonisë e datës 31.10.2019; Kërkesa për pushim prindëror e datës 30.10.2019; Vendim Ref:Ke-510 i datës 22.06.2020 për transferimin e përhershëm, Kërkesë e përsëritur për lejimin e transferimit të përhershëm të zyrtarit ligjor e datës 19.06.2020; Përgjigje në kërkesë e datës 19.06.2020; Vendim Ref. KE-35/20 i datës 15.01.2020, për transferimin e përhershëm, Njoftim lidhur me kërkesën për transferim të zyrtarit i datës 15.01.2020; Kërkesë për transferim të përhershëm e datës 14.01.202; Kërkesë për punësim në punë e datës 31.12.2019; Vendim Ref. KE-539/20 i datës 30.06.2020, për transferimin e përhershëm; Përgjigje në kërkesë e datës 30.06.2020; Kërkesë me nr. 2507 e datës 30.06.2020; Vendim Ref. KE-413/20 i datës 15.01.2020, për transferimin e përhershëm; E-mail i datës 02.06.2020 nga Udhëheqësi i Njesisë së Prokurimit lidhur me lejimin për transferim të përhershëm të Zyrtares për prokurim; Kërkesë e datës 29.05.2020 për plotësimin e vendit të punës Zyrtar i të Hyrave dhe Parasë se imët në APK, Vendim Ref. KE-540/20 i datës 30.06.2020 për transferimin e përhershëm Kërkesë e datës 30.06.2020; Vendim Ref. KE-282/20 i datës.01.04.2020, për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil, Marrëveshje për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil e datës 31.03.2020; Kërkesë e datës 01.04.2020; Vendim Ref:Ke-860/2020 i datës 10.11.2020 për përfundimin e marr dhënies së punës për shkak të vdekjes së nëpunësit civil; Vendim Ref; KE-234/2020 i datës 09.03.2020 për miratimin e dorëheqjes dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës; Njoftim për dorëheqjen vullnetare nga vendi i punës e zyrtares për çështje juridike pranë DK-rajonale në Pejë i datës 09.03.2020; Akt Emërimi SBNJ-211/2020 i datës 11.12.2020 për pozitën Zyrtar Ligjor 2; Ndryshim dhe Plotësim i Akt Emërimit SBNJD-360/2020 i datës 12.12.2019; Akt Emërimi SBNJ-313/2018 i datës 12.12.201; Autorizimi i MAP i datës 04.09.2018 lidhur me pozitën Zyrtar Ligjor 2; Vendim Ref: Ke 869/2020 i datës 10.11.2020 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, Vendim Ref:KE 179/2020 i datës

27.02.2020 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit; Evidenca lidhur me Trajnimet e mbajtura në vitin 2020 nga stafi i APK-së, Formularët për Evidencë së ardhjes në punë në Agjencinë Pyjore të Kosovës prej datës 01.12.2020 deri 31.12. 2020; Padi për hapje të konfliktit administrativ kundër Vendimit të Këshillit A.nr.302/2020 të datës 07.12.2020.

1. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Këshilli, gjatë vizitës që ka bërë në Agjencinë Pyjore të Kosovës, më datë 06 dhe 07 Prill 2021, ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren Nr.16/2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës. Këshilli gjatë vizitës nuk është informuar se Agjencia Pyjore e Kosovës ka filluar me Rregulloren e Re për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës.

Në vitin 2020 sipas Ligjit për Buxhet 2020, në këtë institucion numri i lejuar i pozitive ka qenë 162 nga të cilat 127 nëpunës civile të karrierës, tre nëpunës civil jo të karrierës dhe 32 pozita shërbyes Ppblikë. Numri aktual i nëpunësve civil në vitin 2020 ka qenë 123, ndërsa institucioni ka pasur 6 pozita të lira.

- Gjatë vizitës monitoruese Këshilli ka shqyrtuar pesë (5) dosje të nëpunësve civil dhe atë për pozitën *Zyrtar për Sivikulturë, Zyrtar për Planifikim dhe Shfrytëzimin e Pyjeve, Inspektor për Silvikulturë, Inxhinier i Pylltarisë dhe Drejtor i Drejtoratit për Hulumtim, Projektim dhe Prodhim Fidanor.*
- Këshilli duke u bazuar në dëshmitë e ofruara ka konstatuar se në këtë institucion gjatë vitit 2020 ka pasur vetëm një pozitë me ushtrues detyre.
- Sipas deklaramit të Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore dhe bazuar në emalin e datës 22.09.2020, Kolegji ka gjetur se ky institucion ka përgatitur listën e deklaramit të statusit të zyrtarëve publikë dhe e njëjta është përcjell në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme mirëpo ende nuk ka përfunduar si proces, pasi që nuk ka verifikim nga kjo e fundit.

Këshilli gjatë shqyrtimit të dosjeve ka konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Këshilli gjatë shqyrtimit të dosjeve të personelit, gjegjësisht mostrave të marra ka gjetur se dosjet e personelit në përgjithësi kanë qenë të kompletuara, përjashtimisht që nuk

përmbajnë formularin e përmbajtjes së dosjeve personale të nëpunësit civil, respektivisht fletën prezantuese, siç parashihet me dispozitat e nenit 4 paragrafi 3 dhe 4 të Rregullores (MPB) Nr.01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Me dispozitat e Rregullores (MPB) Nr.01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, përkatësisht nenin 4 paragrafi 3 dhe 4 përcaktohet se: 3. *Dosja personale e zyrtarit publikë duhet të shoqërohet nga fleta prezantuese e krijuar nga zyrtari përgjegjës i Njesisë së menaxhimit të burimeve njerëzore e cila ka formën dhe përmbajtjen sipas shtojcës nr. 1.2, bashkëlidhur kësaj rregulloreje;* 4. *Fleta prezantuese sipas paragrafit 3 të këtij neni nënshkruhet nga zyrtari i autorizuar i njesisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit përkatës dhe nga vetë zyrtari publik, për të cilin është krijuar dosja personale.*

Të gjitha institucionet që punësojnë zyrtarë publikë, janë të detyruar të krijojnë dhe administrojnë dosjen personale të çdo të punësuarit në institucionin e tyre (dosja individuale). Dosja personale e zyrtarit publikë është individuale dhe krijohet që nga data e punësimit dhe përmban të dhëna: profesionale, personale, masat disiplinore, vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë, si dhe të dhëna të tjera sipas shtojcës 1.1 të Rregullores (MPB) Nr.01/2020.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë Pyjore të Kosovës që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për eliminimin e shkeljes së lartcekur, në mënyrë që të gjitha dosjet e personelit të jenë në pajtim me dispozitat e Rregullores (MPB) Nr.01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

E GJETURA 2: Këshill për monitorimi e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka gjetur se Agjencia Pyjore e Kosovës me datë 22.09.2020 ka dërguar në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik të Ministrisë së Punëve të Brendshme, listën e zyrtarëve për verifikim të statusit të Zyrtarëve Publikë, por që ende nuk ka përfunduar si proces pasi që nuk ka verifikim nga kjo e fundit.

Me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 83 paragrafi 16 përcaktohet se: 16. *Deklarimi apo rregullimi i statusit të punësimit të çdo personi, sipas paragrafëve 1- 8 të këtij neni, bëhet me propozim të institucionit dhe me miratimin e Njesisë*

përgjegjëse, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Procedura e deklarimit/rregullimit zhvillohet sipas Ligjit për Procedurën Administrative. Procedura lidhur me deklarimin e statusit të zyrtarëve publikë është përcaktuar me Rregulloren (QRK) Nr.10/2020 Për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë.

Këshilli, konstaton se deklarimi i statusit të zyrtarëve publik ka qenë obligim ligjor që është dashur të përfundoj brenda afateve ligjore të përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2020 Për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë.

Rekomandimi 2: : Rekomandojmë Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë Pyjore të Kosovës që të përfundojë procesin e deklarimit të statusit të zyrtarëve publikë, sipas dispozitave të nenit 83 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë, dhe të sigurohet se deklarimi i statusit të bëhet përmes nxjerrjes së aktit administrativ sipas dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ

E GJETURA 3: Këshilli gjatë vizitës monitoruese ka konstatuar së në vitin 2020 në Agjencinë Pyjore të Kosovës ka pasur vetëm një pozitë me ushtrues detyre, rrjedhimisht sipas Vendimit Ref: KE-72/20 të datës 31.03.2020 të Kryeshefit Ekzekutiv të APK-së, Zyrtari për Monitorim dhe Mbrojtje të Pyllit është caktuar ushtrues detyre i Inspektorit të Pylltarisë në DQIPGJ-Pejë, duke u bazuar në nenin 30 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil.

Këshilli nga analizimi i Vendimit Ref Ke-72/20 të datës 31.03.2020 ka konstatuar se Vendimi nuk ka përcaktuar afatin ligjor për ushtrimin e përkohshëm të detyrës ashtu siç parashihet me nenin 30 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që rrjedhë se është tejkaluar afati ligjor i përcaktuar me këto dispozita ligjore. Ndërsa me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 Zyrtarët Publikë është dashur të behët shfuqizimi i këtij vendimi ashtu siç është kërkuar me nenin 83 paragrafi 10 të këtij ligji.

Neni 30 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përcaktonte se: *Në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj, ndërsa në rastin konkret është tejkaluar afati ligjor.*

Ligji Nr.06/L-114 Zyrtarët Publikë përkatësisht neni 83 paragrafi 10 parasheh se: *Hyrja në fuqi e këtij ligji përbën shkak ligjor për përfundimin e marrëdhënieve të punës me ushtruesit e përkohshëm të detyrës së zyrtarëve publikë. Ushtruesit e detyrës kthehen në vendin punës.*

Kurse me nenin 32 paragrafi 4 të Ligji Nr.06/L-114 Zyrtarët Publikë përcaktohet se: *Përfundimisht, një pozitë e rregullt pune në Shërbimin Civil mund të plotësohet në rast të nevojës të zëvendësimit apo mungesës së përkohshme të një nëpunësi civil varësisht nga rasti, për një periudhë jo më të gjatë se 12 (dymbëdhjetë) muaj. Në këtë rast, procedurat e pranimit zhvillohen nga Njësia e Burimeve Njerëzore, në pajtim me rregullat e përcaktuara me këtë ligj për nëpunësin administrativ dhe mbështetës.*

Këshilli vlerëson së dispozitat e Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, përkatësisht neni 18 paragrafi 5, neni 19 paragrafi 4 dhe neni 20 paragrafi 3 i referohen rasteve kur pozitat e punës janë të plotësuara me nëpunës civil mirëpo në raste të caktuara kur nëpunësi civil përkohësisht nuk mund të ushtroj detyrën për arsye të ndryshme si p.sh gjendet në pushim vjetor, mjekësor, vizitë jashtë vendi, etj, zëvendësohet nga nëpunësi civil sipas kritereve të përcaktuara me dispozitat e lartcekura ligjore.

Ndërsa dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 32 paragrafi 4 i referohet rasteve të zëvendësimit apo mungesës së përkohshme të nëpunësit civil të përhershëm, dhe ky zëvendësim mund të behet për një periudhë jo më të gjatë se 12 muaj, p.sh zëvendësimi i nëpunësit civil që gjendet në pushim të lehonisë, pushim pa pagesë, etj. Zëvendësimi në rastet e tilla bëhet përmes procedurave të pranimit që zhvillohen nga Njësia e Burimeve Njerëzore, në pajtim me rregullat e përcaktuara me këtë ligj për nëpunësin administrativ dhe mbështetës.

Plotësimi i pozitave të lira është dashur të bëhet përmes zhvillimit të procedurave të lëvizjes brenda kategorisë apo ngritjes në detyrë siç përcaktohet me dispozitat e nenit 38 dhe 39 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Deri në plotësimin e vendit të lirë, organi i punësimit ka mundur të zbatojë procedurat e transferimit të përkohshëm të nëpunësit civil në interes të institucionit, të përcaktuar në nenin 52 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Rekomandimi 3: Rekomandojmë Kryeshefin Ekzekutiv që t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për eliminimin e shkeljeve të konstatuara në mënyrë që plotësimi i pozitave të lira të behet në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Këshilli bazuar në deklarin e Menaxheres se Personelit ka gjetur se në Agjencinë Pyjore të Kosovë gjatë vitit 2020 nuk është zhvilluar ndonjë procedurë rekrutimi përfshirë edhe procedurat e avancimit.

Në vitin 2020, Agjencia Pyjore të Kosovës nuk ka pasur të lidhura marrëveshje për shërbime të veçanta.

Në këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Këshilli në proces të monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislationit për shërbimin civil, ka gjetur se Agjencia Pyjore e Kosovë ka themeluar Komisionin Disiplinor sipas Vendimit Ref.KE-309/2020 të datës 27.04.2020 të Kryeshefit Ekzekutiv të APK-së, i njëjti është anuluar me Vendimin Ref.KE-740/2020 të datës 17.09.2020, duke u emëruar Komisioni i ri Disiplinor, bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Gjatë vitit 2020 në Agjencinë Pyjore të Kosovës janë zhvilluar dy (2) procedura disiplinore ndaj nëpunësve civil. Me Vendimin Nr. ref:SBNJD-83/2020 të datës 13.02.2020 të Komisionit Disiplinor nëpunësi civil është shpallur përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore dhe të njëjti i është shqiptuar masa disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës. Ndërsa me Vendimin Ref.KE-32/2020 të datës 06.02.2020 të Komisionit Disiplinor nëpunësi civil është shpallur përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore dhe të njëjti i është shqiptuar masa disiplinore pezullim i ushtrimit të detyrave dhe ndalim i 1/3 e rrogës për një periudhë një (1) muaj.

Në këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Këshilli, gjatë procesit të monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, ka konstatuar se deri në hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë (datë 09.07.2020) në Agjencinë Pyjore të Kosovës ka vepruar Komisioni për Zgjidhjen e

Kontesteve dhe Ankesave sipas Vendimit Ref:-KE-310/2020 të datës 27.04.2020 të Kryeshefit Ekzekutiv të APK-së. Në vitin 2020 janë trajtuar 2 ankesa nga KZKA-ja ku që të dy ankesat janë refuzuar si të pabazuara.

Kundër vendimeve të Komisionit për Zgjidhen e Kontesteve dhe Ankesave, nëpunësit civil kanë ushtruar dy ankesë në KPMSHCK, ndërsa në Këshill ka pas pesë (5) ankesa. KPMSHCK-ja ka vendosur vetëm për një ankesë sipas ankesës së ankuesit përmes vendimit A.nr.1186/2021 të datës 14.01.2022 ka shfuqizuar vendimin e KZKA-së Ref:SMBNJD-120/20 të datës 28.04.2020 dhe Vendimin e Komisionit Disiplinor, Ref:SMBNJD-83/20 të datës 13.03.2020, ndërsa lidhur me ankesat e tjera KPSHCK-ja ka njoftuar ankuesit lidhur me pamundësinë e vendosjen së ankesës së tij, për shkak se Këshilli ka qenë jofunksional dhe të njëjtit i e ka udhëzuar që ti drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative.

Në këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Sipas Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore, në Agjencinë Pyjore të Kosovës janë bërë vlerësimet e rezultateve të punës për nëpunësit civilë për vitin 2020, dhe së të gjithë nëpunësit janë vlerësuar, ku tre (3) nëpunës civil janë vlerësuar për periudhën provuese.

Në këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Këshilli për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Agjencinë Pyjore të Kosovës mbahet evidenca e nëpunësve civil në kopje fizike dhe elektronike. Gjatë vitit 2020, 28 nëpunës civil kanë realizuar pushimet mjekësore dhe 2 nëpunëse civile kanë qenë në pushim të lehonisë.

Bazuar në analizimin e mostrave të marra, pushimet vjetore janë të shoqëruar me kërkesë paraprakë për pushim, pushimet mjekësore janë të shoqëruara me dëshmi mjekësore dhe po ashtu vendimet për pushim të lehonisë kanë qenë në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm, kështu që mund të konstatojmë se janë respektuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjit Nr.03/L-212 të Punës.

Në këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Këshilli, gjatë monitorimit në këtë fushë, ka konstatuar se në Agjencinë Pyjore të Kosovës, gjatë vitit 2020 janë bërë 6 transferime të përhershme të nëpunësve civil dhe atë si vijon:

- sipas Vendimit Ref:KE-510/2020 të datës 22.06.2020 është bërë transferimi i Zyrtarit Ligjor 2 në Drejtoratin Ligjor në pozitën e punës Zyrtar Ligjor 2 në DKR në Prishtinë;
- sipas Vendimit Ref:KE-35/2020 të datës 15.01.2020 është bërë transferimi i Zyrtarit për Monitorim dhe Mbrojtje të Pyllit në DKR-Prishtinë në pozitën Zyrtar për Monitorim dhe Mbrojtje të Pylli në DKR në Pejë;
- Sipas Vendimit Ref:KE-539/2020 të datës 30.06.2020 është bërë transferimi i Asistentes Administrative 3 në Drejtoratin Ligjor në pozitën Asistente Administrative 3 në Zyrën e Kryeshefit Ekzekutiv të APK-së;
- sipas Vendimit Ref:KE-3413/2020 të datës 02.06.2020 është bërë transferimi i Zyrtares së Prokurimit në DKR-Prishtinë në pozitën Zyrtare e të Hyrave Financiare në DFSHP-APK;
- sipas Vendimit Ref: KE-540/2020 të datës 30.06.2020 është bërë transferimi i Asistentes Administrative 4 në Zyrën e Kryeshefit Ekzekutiv të APK-së në pozitën Asistente Administrative 4 në Drejtoratin Ligjor-Qendër;
- sipas Vendimit Ref: KE-232/2020 të datës 01.04.2020 është bërë transferimi Zyrtare për të Hyra Financiare në DSHP-AKP në pozitën Zyrtare e Divizionit të Prokurimi, në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Këshilli nga analizimi i këtyre vendimeve ka konstatuar se vendimet për transferim të përhershëm dhe marrëveshjet për transferim janë lidhur mbi bazën e dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

Në këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Këshilli, gjatë monitorimit në këtë fushë, ka konstatuar se në Agjencinë Pyjore të Kosovës ka të punësuar gjithsej 152 zyrtarë, nga të cilët njëqind e njëzet e tre (123) nëpunës civilë me përfaqësim si vijon:

- përfaqësimi gjinor i përgjithshëm: 121 nëpunës meshkuj nga 97 nëpunës civil, gjithsej 31 femra nga të cilat 26 nëpunëse civile.

- përfaqësimi etnik i përgjithshëm: 135 shqiptarë, 10 serb dhe 1 boshnjak

- përfaqësimi i personave më nevoja të veçanta: nuk ka të punësuar persona me nevoja të veçanta

E GJETURA 4: Bazuar në të dhënat e ofruara nga Menaxherja e Personelit të Agjencisë Pyjore të Kosovës rrjedhë se 80 % e të punësuarve janë meshkuj ndërsa 20% femra, çka nënkupton se nuk ka numër të barabartë të punësuarve ashtu siç përcaktohet me dispozitat Ligjit Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore. Po ashtu lidhur me punësimin e personave me aftësi të veçanta, nuk kemi respektim të Ligjit Nr. 03/L-019 Për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, sepse në këtë institucion nuk ka të punësuar asnjë person me aftësi të veçanta.

Sipas nenit 12 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 03/L-019 Për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara Punësimi në tregun e hapur të punës *1. Organet e administratës shtetërore, punëdhënësit e sektorit privat dhe publik si dhe organizatat joqeveritare obligohen që, me kushtet e përshtatshme të punës ti punësojnë personat me aftësi të kufizuara. 2. Çdo punëdhënës është i obliguar të punësojë një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor.*

Rekomandimi 4: Rekomandojmë Kryeshefin Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës që me rastin e rekrutimit të stafit të ri, të ketë parasysh respektimin e dispozitave të Ligjit Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore si dhe nenin 12 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 03/L-019 Për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, ashtu që për çdo 50 punëtorë një nëpunës civil duhet të jetë nëpunës me aftësi të kufizuara.

9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Këshilli gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Agjencinë Pyjore të Kosovës gjatë vitit 2020 nuk ka pasur asnjë rast të pezullimit të punës në shërbimin civil, ndërsa ka pasur vetëm një rast të përfundimit të marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit sipas vendimit Ref:KE-179/20 të datës 27.02.2020, një rast të përfundimit të marrëdhënies së punës për shkak të vdekjes së nëpunësit civil sipas Vendimit Ref:KE-869/2020 të datës 10.11.2020 dhe një rast i ndërprerjes së marrëdhënies së punës për shkak të dorëheqjes së nëpunësit civil.

E GJETURA 5: Këshilli me rastin e Vlerësimit të Vendimit Ref.KE-869/2020 të datës 10.11.2020 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil për shkak të vdekjes së nëpunësit civil ka gjetur së në provat e ofruara nuk ka dëshmi se është bërë kompensimi në rast të vdekjes së një nëpunësi civil, për familjarët e tij për pagesë të njëhershme në vlerë prej një (1) page mujore, ashtu siç parashihet me nenin 22 paragrafi 1 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil

Rekomandimi 5: Rekomandojmë Kryeshefin Ekzekutiv dhe Menaxherin e Burimeve Njerëzore të Agjencisë Pyjore të Kosovës që të ndërmarrin të gjitha veprimet për eliminimin e shkeljes sipas të kësaj të gjeture dhe të veprojnë në pajtim me nenin 22 paragrafi 1 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil si dhe neni 87 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës.

10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Këshilli gjatë shqyrtimit të dosjeve të marra si mostër dhe sipas deklaramit të udhëheqësit të njësise përgjegjëse ka konstatuar se në këtë institucion nuk ka raste ku nëpunësi civil në të njëjtën kohë mbanë dhe ndonjë post tjetër publikë.

Në këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime

11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Këshilli për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil bazuar në deklaramin e udhëheqësit të njësise përgjegjëse ka gjetur se në Agjencinë Pyjore të Kosovës në vitin 2020 nuk ka asnjë nëpunës civil ndaj të cilit është duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ose është dënuar me vendim të gjykatës.

Në këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Lidhur me këtë fushë të monitorimit, Këshilli ka konstatuar se Agjencia Pyjore e Kosovës, ka përgatitur planin e trajnimeve për vitin 2020 lidhur me trajnimin e nëpunësve civil në fushën që ndërlidhet sipas Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës. Në trajnime kanë marrë pjesë gjithsej 19 zyrtarë, dhe se institucioni mbanë evidenca lidhur me trajnimet e mbajtura të stafit. Trajnimet janë mbajtur në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, MF, CNP.

Në këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

13. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE KLASIFIKIMI I VENDEVE TË PUNËS

Këshilli gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Agjencia Pyjore e Kosovës ka në fuqi Rregulloren Nr.16/2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës.

Neni 28 i Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura përcakton se: 1. *Rregullorja për organizimin e brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore përbëhet nga: 1.1. struktura funksionale; 1.2. organogrami i detajuar i institucionit, që përfshin edhe klasën e secilës pozite të punës dhe grupin e çdo pozite të kategorisë profesionale në pajtim me dispozitat për klasifikimin në Shërbimin Civil sipas Ligjit për Zyrtarët Publikë ; 1.3. misionin dhe përshkrimin e punës të çdo njësie të brendshme administrative. 2. Rregullorja për organizimin e brendshëm të ministrive dhe të agjencive ekzekutive përfshin edhe degët lokale, të cilat janë pjesë e tyre. 3. Organizimi i brendshëm i ministrive dhe agjencive ekzekutive miratohet me akt nënligjor nga Kryeministri, në bazë të propozimit të ministrit përgjegjës dhe miratimit paraprak të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe opinionit të ministrit përgjegjës për financat.*

E GJETURA 6 : Këshilli gjatë vizitës nuk është informuar së Agjencia Pyjore e Kosovës ka filluar me Rregulloren e Re për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës.

Rekomandimi 6: Rekomandojmë Kry shefin Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore, që të ndërmerr verpime të nevojshme për nxjerrjen e Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e

14. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET

Këshilli në procesin e monitorimit të zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, dhe sipas deklaramit të menaxherit të Personelit ka konstatuar se në Agjencinë Pyjore të Kosovës vijueshmëria në punë mbahet në formë fizike, të gjitha pagat e nëpunësve civil janë në pajtim me Akt Emërimet po ashtu asnjë nëpunës civil nuk kompensohet me ndonjë shtesë.

Në këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

15. NGACMIMET SEKSUALE

Gjatë vizitës së monitorimit nuk na është raportuar asnjë rast në këtë fushë dhe për këtë nuk kemi të gjetur dhe rekomandim.

Në këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

16. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Këshilli për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Agjencinë Pyjore të Kosovës, nuk ka pasur rekomandime sepse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka qenë jo funksional në mungesë të kuorumit.

Lidhur e zbatimin e vendimeve të Këshillit, konstatohet se në vitin 2020 është vendosur vetëm për një ankesë kundër APK-se sipas Vendimit A.nr.302/2020 të datës 13.10.2020 i cili është zbatuar nga APK-ja sipas njoftimit me numër protokolli 3162/2020 të datës 15.12.2020.

**17. SHËNIMET/KOMENTET/KONKLuzionET E PËRGJITHSHËM PËR
MIBKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË
LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL**

Këshillit gjatë shqyrtimit dhe inspektimit të të dhënave të dosjeve për fushat e mbikëqyrjes, ka konstatuar gjashtë (6) të gjetura dhe ka dhënë gjashtë (6) rekomandime për veprim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon menaxhmentin e lartë të Agjencisë Pyjore të Kosovës, që gjetjet me rekomandimet e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil.

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Rushit Kajtazi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Raporti i dërgohet:

- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës;
- Menaxherit të Personelit në Agjencinë Pyjore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK.